



Universiteti Bujqësor i Tiranës



Qendra "Trees for Lure"

Nr. prot. 306, Datë 31.01.2024

Nr. ____ Prot., Datë _____.2024

MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

ndërmjet

UNIVERSITETIT BUJQËSOR TË TIRANËS

dhe

QENDRA "TREES FOR LURE"

Sot, më datë 31.01.2024 lidhet ky memorandum bashkëpunimi midis palëve:

1. **Qendra „Trees for Lure“**, me NIPT M02208452W adresë Rruga Rr. Pjetër Bogdani Nd 10, H 5, Apt 28, 7th Floor, 1019, Tirane, Shqipëri, e përfaqësuar nga Drejtuesi Ekzekutiv Z. Pavel KUNC, quajtur këtu e në vijim si **“Qendra”**;

dhe

2. **Universiteti Bujqësor i Tiranës**, me NIPT: **J61915028N**, me adresë Rruga Pajsi Vodica 1025, Tirane, Shqipëri, përfaqësuar nga Prof. Dr. Fatbardh SALLAKU në cilësinë e Rektorit të Universitetit Bujqësor të Tiranës, këtej e në vazhdim cilësuar si **UBT**;

Të quajtura bashkarisht ose veçmas si "Palët".

Duke qenë se:

Palët kanë shprehur vullnetin për ngritjen e urave të bashkëpunimit midis tyre për mundësimin e angazhimeve të përbashkëta në studime, trajnime, seminare, konferenca, procese të vlerësimit të shërbimeve, standarteve dhe kapaciteteve në ofrimin e shërbimeve, praktikave mësimore, si dhe në hartimin e politikave të reja sociale, programeve dhe projekteve të shërbimeve për grupe dhe komunitete në nevojë, palët bien dakort të nënshkruajnë këtë memorandum bashkëpunimi me kushte si më poshtë vijon:

Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i këtij memorandumi është përcaktimi i rregullave të bashkëpunimit dhe njohja e ndërsjelltë, ngritja dhe zhvillimi i mëtejshëm i njohurive profesionale dhe akademike, ngritja e kapaciteteve të stafit dhe studentëve si dhe shkëmbimi i praktikave më të mira në fushat me interes të përbashkët midis palëve.

Neni 2 Objekti

Objektivat e këtij bashkëpunimi mes Qendra Trees For Lure dhe UBT si më poshtë:

1. Angazhimi i përbashkët i stafit mësimdhënës/student të interesuar për kërkime mbi agropylltarinë përkatëse me objektivat e Trees for Lure;
2. Aktivitete trajnuese;
3. Shkëmbimi i ndërsjellë i publikimeve dhe informacionit teknik;
4. Zhvillimi i proceseve/procedurave që monitorojnë/vlerësojnë standardet apo shërbimet e Projektit;
5. Angazhimi në dialog me të gjithë aktorët për të zhvilluar dhe propozuar politika që nxisin menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve, burimeve natyrore, biodiversitetit dhe përmirësimin e angazhimit të komuniteteve pyjore;
6. Aktivitete të tjera të përbashkëta në përputhje me objektivat e të dyja palëve.

Neni 3 Baza ligjore

Ky memorandum bazohet në:

- a) ligjin nr. 7850, datë 29.07.1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë" (i ndryshuar);
- b) ligjin nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë";
- c) ligjin nr. 9887, datë 10.3.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" (i ndryshuar);
- d) Ligji nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë",
- e) Ligji nr.15/2019 "Për nxitjen e punësimit",
- f) Ligjit nr. 15/2017 "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar,
- g) Statuti i Universitetit Bujqësor të Tiranës, si dhe aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tyre.

Neni 4

Angazhimet e palëve

1. Palët marrin përsipër të bashkëpunojnë bazuar në frymën e një mirëkuptimi reciprok dhe vullneti pozitiv për të siguruar kushtet e nevojshme për realizimin e angazhimit dhe inicitivave të ndërmarra nga palët.
2. Qendra Trees for Lure merr përsipër të organizojë evente informimi, mbështetje të studenteve në proceset e aktivitetit të saj.
3. UBT merr përsipër të ofrojë mbështetje;
 - ndaj Qendrës në realizimin e aktiviteteve me interes të ndërsjelltë;
 - nëpërmjet ekspertizës që disponon, në funksion të realizimit të aktiviteteve të përbashkëta me Qendrën, dhe sipas rastit dhe mundësive të dakordësuar paraprakisht;
 - nxitjen e studentëve për pjesëmarrje në aktivitete të përbashkëta me Qendrën;
 - të jetë promotor i aktiviteteve të përbashkëta me Qendrën.
4. Në lidhje me përmbledhjen, përpunimin apo transferimin e të dhënave personale gjatë zbatimit të angazhimeve të parashikuara nga ky memorandum, palët marrin përsipër të përmbushin të gjitha detyrimet që burojnë nga kuadri ligjor në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

Neni 5

Personi i kontaktit

1. Personat e kontaktit do të jenë përgjegjës për zbatimin e këtij memorandumi, me qëllim realizimin e objektivave duke komunikuar dhe shkëmbyer të dhënat në mënyrë sa më korrekte dhe efektive.
2. Personat e kontaktit për secilën palë, në kuadër të implementimit të këtij memorandumi janë:

Për Qendrën:

Z. Pavel Kunc, Drejto Ekzekutiv

Email: pavel@treesforlure.org

Për UBT:

Z. Shpresim Domi, Drejtoria e Shërbimeve Mësimore dhe Studentëve, UBT

Email: shdomi@ubt.edu.al

3. Në rast të ndryshimit të njërit prej këtyre personave, pala e cila përfaqësohet prej këtij personi duhet të njoftojë me shkrim palën tjetër nënshkruese brenda një jave kalendarike për të dhënat e personit të ri të kontaktit.

Neni 6

Afati

1. Ky memorandum lidhet për një afat **5 vjeçar**.
2. Afati fillon nga data e nënshkrimit të këtij Memorandumi nga të dy palët.
3. Çdonjëra nga palët mund të kërkojë të zgjidhë memorandumun duke lajmëruar palën tjetër me shkrim të paktën një muaj përpara datës së zgjidhjes.

Neni 7
Mosmarrëveshjet

Çdo mosmarrëveshje, keqkuptim apo keqinterpretim në realizimin e këtij memorandum do të zgjidhet me mirëkuptim midis palëve, në frymën e bashkëpunimit, tolerancës dhe kuadrit të etikës morale.

Neni 8
Dispozita kalimtare

1. Palët janë të detyruara të respektojnë këtë memorandum bashkëpunimi për të gjithë kohëzgjatjen e parashikuar në Nenin 6.
2. Memorandumi mund të ndryshohet vetëm nëpërmjet një marrëveshje me shkrim të nënshkruar nga të dyja palët.
3. Kushtet e këtij Memorandumi Bashkëpunimi pranohen dhe nënshkruhen nga të dyja palët.

Neni 9
Konfidencialiteti

Të dy palët bien dakort të respektojnë kushtet e konfidencialitetit.
Ky memorandum do të dorëzohet në 3 (tree) kopje, nga të cilat 1 (nje) mbahet nga Qendra Trees for Lure dhe 2 (dy) mbahen nga UBT.

PALËT NËNSHKRUESE

Firmosur në UBT më datë 31/01/2024, në tre kopje origjinale.

**UNIVERSITETI BUJQËSOR I
TIRANËS**

Prof. Dr. Fatbardh SALLAKU



QENDRA TREES FOR LURE

Z. Pavel KUNC